

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FAST TRANS” SH.P.K

Me cilësinë e ortakëve themelues , sot më datën 22 dhjetor 2021:

1. Enxhi Jegeni, atësia Rreoland, lindur më 05.06.1993 ne Tiranë dhe banuese në rruga “Nikolla Lena”pallati 126/1, ap. 9, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikur nga karta e identitetit nr.034732345 dhe nr. personal J35605057S;
- Bora Asllani, atësia Bardhyl, lindur më 23.12.1993 ne Peshkopi dhe banuese në rruga “Selam Musai”, pallati 12, H. 1, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikur nga karta e identitetit nr.035450198 dhe nr. personal J36223049P;;

Kanë vendosur të nënshkruajnë aktin e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar(më poshtë Shoqëria), aktiviteti I të cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti I saj, I cili është pjesë përbërëse e ketij akti, së cilës I bashkëngjitet(më poshtë shtojca 1).

NENI 1

EMËRTIMI

Shoqëria emërtohet **“FAST TRANS” SH.P.K.**

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria e ka selinë në adresën Pasuria nr. 108, Rruga e Allit, Shushicë, Elbasan.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria **“FAST TRANS”** ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Transport inertesh kombetar dhe nderkombetar per vete dhe te trete. Kerkimi, zbulimi dhe shfrytezimi i mineraleve te dobishme dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit. Perdorim dhe tregtim i lendeve plasese. Import eksport, tregtim me shumice e



pakice te mallrave te ndryshme industriale, materiale te ndertimit, produkteve bujqesore, blegtorale, ushqimore etj. Grumbullim, perpunim, eksport dhe tregtim me shumice e pakice te bimeve medicinale, produkteve dhe nenprodukteve bujqesore, blegtorale dhe pyjore. Grumbullim, perpunim dhe tregtim te te gjitha llojeve te metaleve, lende te pare ndertimi, mineraleve dhe te te gjitha llojeve te metaleve me ngjyre dhe pa ngjyre: Prodhim, grumbullim, perpunim dhe tregtim te te gjitha llojeve te inerteve, lende te pare ndertimi, import eksport i tyre. Dhenia me qera e materialeve te ndertimit, skela, makineri etj. Projektim, ndertim, te objekteve social kulturore, ekonomike, industriale, objekte banimi. Tregtim pajisje hidraulike, pajisje hidrosanitare dhe aksesore te tyre dhe te gjitha materialeve qe lidhen me fushen e ndertimit. Import dhe tregtim me shumice e pakice te makinerive dhe pajisjeve 2 te ndryshme industriale, pjese kembimi per to. Import dhe tregtim me shumice e pakice te automjeteve te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to. Servis automjetesh. Agjensi udhetimesh turistike. Agjensi imobiliare. Agjensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar. Veprimtari hoteliere, bar-bufe, restorant. Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhimi dhe tregtimi i materialeve te ndertimit, import eksporti i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise dhe te treteve. Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim jo vetem ngritjen por edhe shfrytezimin dhe zhvillimin e veprimtarive ne fushen e hotelerise dhe te fshatrave turistike te pushimit, qendrave te argetimit, brenda dhe jashte vendit, si dhe te bleje, te marre dhe te jap me qira, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre duke vepruar ne kete fushe apo me partnere te tjere. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje fdo aktivitet tjeter plotesues dhe ndihmes qe ka si qellim ofrimin e cdo aktiviteti tjeter, ne rast se rezultojne te dobishme dhe/ose te nevojshme per permbushjen e objektit kryesor, si dhe cdo aktivitet tjeter qe konsiderohet fitimprures dhe ne interes te shoqerise.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar shoqërisë ka vlerën 100 000 (njëqind mijë) lek dhe përfaqëson 2 kuota.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Enxhi Jegeni: zotërues I 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 50000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Bora Asllani: zotëruese e 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 (pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6

TRANSFERIMI I KAPITALIT



Pjesët e kapitalit themeltar te shoqërisë mund tu transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm pasi ato I janë ofruara më parë ortakëve të tjerë të saj dhe janë refuzuar për tu blerës prej tyre me cmimin e paraqitur zyrtarisht nga ortaku shitës.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmejt ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve

NENI 7

ADMINISTRIMI&KOMPETENCAT

1. Me këtë akt emërohet 1(një) administrator I shoqërisë, personi si më poshtë:

Zj. Xhuliana Isufi, qytetare shqiptare, lindur në Greqi dhe banuese në Tiranë, me nënshtetësi shqiptare, me letërnjoftim me numër personal K05101036F. Zj. Xhuliana Isufi do të përfaqësojë shoqërinë në të gjithë veprimtarinë e saj për një periudhë 5 vjecare.

2. Administratori ka të drejtë e detyrim të:

- a. Kryejë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. Të pregatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe të propozojë shpërndarjen e fitimeve;
- d. Është I autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj në qendrën kombëtare të biznesit.
- e. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut

NENI 8

GJUHA

Ky akt-themelimi u hartua në 4(katër)kopje në gjuhën shqipe, dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët e shoqërisë "FAST TRANS" Sh.P.K., nënshkruhet në të gjitha kopjet, duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

Ortakët Themelues

Enxhi Jegeni

Bora Asllani